




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Graçanicës (KG), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Graçanicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar për vlerën prej 1,418,635€ në PVF.
- B2 Pasurite kapitale në PVF ishin mbivlerësuar për vlerën 31,516€, dhe stoqet ishin nënvlerësuar për 499,330€, për shkak të mos regjistrimit të tyre dhe mos raportimit të saktë të tyre.
- B3 Detyrimet kontingjente në PVF ishin mbivlerësuar për vlerën 93,688€.
- A1 Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë bërë keqklasifikime të shpenzimeve në vlerë prej 56,846€, të cilat do të duhej të paguheshin nga subvencionet dhe transferet. Po ashtu, si rezultat i vendimeve gjyqësore, është bërë një pagesë prej 29,000€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa për nga natyra i takon investimeve kapitale.
- A2 Raporti i obligimeve të papaguara në PVF ishte mbivlerësuar për vlerën prej 26,205€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Graçanicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Në kontratën me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit
- A4 Në 20 raste kemi vërejtur se mësimdhënësit nuk janë të sistemuar në vendin e punës sipas kontratës. Vetëm gjatë vitit 2023, 14 mësimdhënës ishin rekrutuar duke u caktuar si zyrtarë në departamente të ndryshme të Administratës Komunale.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetarja e Komunës është përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetarja e Komunës është përgjegjëse edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetarja e Komunës është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Graçanicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Graçanicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Graçanicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Graçanicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Graçanicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Çështjet më me fokus dhe që kanë ndikuar në opinionin financiar të auditimit janë ato që kanë të bëjnë me prezantimin jo të saktë dhe të plotë në PVF të llogarive të arkëtueshme, detyrimeve kontingjente, pasurive jofinanciare, detyrimeve të papaguara si dhe klasifikimin jo të duhur të shpenzimeve.

Kontrollet mbi të hyrat kanë nevojë të forcohen tek menaxhimi i të hyrave nga tatimi në pronë, dhe aplikimi i zbritjeve për qiratë në përputhje me rregulloret përkatëse.

Fusha për përmirësim të mëtejshëm janë identifikuar tek menaxhimi i kontratave publike, procesi i prokurimit, si dhe tek personeli përkatësisht sistemimi i stafit të sektorit të arsimit jo në përputhje me kontratat e punës. Më tutje, niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm ishte i ulët si dhe komiteti i auditimit ende nuk ishte formuar.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja, dhe katër (4) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Nënvlërimi i llogarive të arkëtueshme në PVF

Gjetja

Sipas nenit 16 të Rregullores MF-nr.01/2017 për raportim vjetor financiar për organizata buxhetore, është përcaktuar që OB-të që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të plotë për shumatat e paarkëtuara.

Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlërësuar për vlerën prej 1,418,635€, si rezultat i mos prezantimit të plotë të borxheve të paarkëtuara nga taksat për ushtrimin e veprimtarisë nga vitet e mëparshme, por duke prezantuar vetëm ato të vitit 2022 dhe 2023 në vlerë prej 444,640€. Përkundër se ky ishte një rekomandim nga viti i kaluar, komuna nuk kishte marrë masa për shpalosjen e saktë të tyre.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të duhura në përmirësimin e regjistrave të llogarive të arkëtueshme dhe në raportimin e drejtë të shpalosjeve në PVF.

Ndikimi

Shpalosja jo e saktë e llogarive të arkëtueshme, ndikon në raportimin jo të drejtë dhe të saktë të informatave financiare, respektivisht në nënvlërimin e tyre në PVF.

Rekomandimi B1

Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, në mënyrë që të përmirësohet procesi i menaxhimit dhe prezantimit të drejtë të

Ilogarive të arkëtueshme në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Prezantimi jo i saktë i pasurive kapitale dhe stoqeve në PVF

Gjetja

Bazuar në Rregulloren MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore “Paraqitja e pasurive në pasqyrat vjetore financiare duhet të bëhet nga: SIMFK-ja për pasuritë mbi 1,000€ dhe afat të përdorimit mbi një vit; dhe e-pasuria për pasuritë me vlerë nën 1,000 € dhe afat të përdorimit mbi një vit dhe stoqet.

Më tutje, sipas nenit 6, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Më tutje, sipas nenit 22 të kësaj rregullore, janë përcaktuar normat e përgjithshme të zhvlerësimit të pasurive, ku përcaktohet se toka nuk amortizohet.

Ne kemi identifikuar se prezantimi i pasurive në PVF nuk ishte bërë në mënyrë të plotë dhe të saktë:

- Pasuritë kapitale ishin mbivlerësuar për 31,515.89€, për shkak se pagesa me vendim gjyqësor për shpronësim të tokës ishte regjistruar në vlerë 64,140.89€ duke përfshirë kamatat dhe shpenzimet tjera procedurale, ndërsa është dashur të regjistrohet vetëm borxhi kryesor në vlerë 32,625€. Po ashtu, kjo pasuri nuk ishte regjistruar në kategorinë e duhur sipas planit kontabël, tek kodi “tokat”, por ishte regjistruar te kodi “kapital tjetër”, dhe si e tillë kishte filluar të zhvlerësohet;
- Stoqet ishin nënvlerësuar për 499,330€, pasi që ato ishin prezantuar në PVF në vlerë 4,788.53€, ndërsa sipas raportit të inventarizimit të pasurive, vlera e materialit shpenzues ishte 504,118.75€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të duhura në fushën e menaxhimit të regjistrave të pasurive nga zyrtarët përkatës.

Ndikimi

Mos regjistrimi i pasurive në kategorinë e duhur dhe vlerën e saktë të tyre, ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurive kapitale dhe nënvlerësimin e stoqeve në PVF.

Rekomandimi B2

Kryetarja duhet të sigurojë se pasuritë kapitale, jokapitale dhe stoqet regjistrohen në kategorinë dhe vlerën e saktë të tyre, në mënyrë që prezantimi i tyre në PVF të jetë i plotë dhe i saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontingjente në PVF

Gjetja

Bazuar në Rregulloren nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, neni 18, organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Detyrimet kontingjente nuk ishin prezantuar në mënyrë të saktë në pasqyrat vjetore financiare. Ato ishin mbivlerësuar për vlerën 93,688€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të duhura lidhur me menaxhimin e regjistrit të detyrimeve kontingjente, me ç`rast zyrarti ligjor kishte përfshirë në regjistër një lëndë e cila ishte hedhur poshtë nga Gjykata në vitin 2022, dhe nuk përbënte më një detyrim kontingjent për komunën.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta, ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF-së të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi B3 Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së PVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Gjatë testimit të shpenzimeve, kemi vërejtur se:

- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë realizuar pagesa në vlerë totale prej 56,846€ të cilat për nga natyra i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesën e transportit për manifestimet e sportit dhe kulturës ku palët si: OJQ, Shoqata të ndryshme, klube të sportit, etj., bëjnë kërkesë për aprovim në Komunë për mbulimin e shpenzimeve të transportit; dhe
- Si rezultat i vendimeve gjyqësore/përmbartimore, një rast prej 29,000€ është paguar direkt nga Thesari nga buxheti për mallra dhe shërbime, ndërsa për nga natyra i takon investimeve kapitale.

Kjo kishte ndodhur për shkak se komuna kishte planifikuar gabimisht këtë projekt në kategorinë jo adekuate të shpenzimeve, ndërsa pagesa përmes vendimit gjyqësor kishte rrjedhur për shkak të mungesës së mjeteve në projektin përkatës.

Ndikimi Pagesat e kryera nga kategoria jo adekuate e shpenzimeve kanë ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësim të kategorive përkatëse dhe për efekt kanë paraqitjen jo të saktë dhe të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi A1 Kryetarja duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mosprezantimi i saktë i detyrimeve të papaguara në PVF**Gjetja**

Sipas nenit 17, pika 3 e Rregullores MF 01/2017 për raportimin vjetor financiar nga Organizatat buxhetore, thekson se OB raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) e krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues, ndërsa pika 1 parasheh që Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë auditimit, kemi identifikuar një rast ku komuna kishte paguar vetëm vlerën prej 81,519.30€ nga një faturë totale prej 107,724.40€, të datës 04.09.2023, për projektin "Rehabilitimi, mirëmbajtja e infrastrukturës dhe intervenimet e ndryshme në Komunën e Graçanicës". Për shkak të mungesës së fondeve, vlera prej 26,205.10€ nuk ishte paguar operatorit ekonomik.

Edhe pse pjesa mbetur e këtij detyrimi ishte ekzekutuar nga Thesari me datë 29.12.2023, komuna e kishte prezantuar atë si detyrim të papaguar në PVF.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme me rastin e shpalosjes së detyrimeve në PVF.

Ndikimi

Mosparaqitja e saktë e vlerës së detyrimeve të papaguara ka ndikuar në mbivlerësimin dhe prezantimin e informatave jo të sakta për shfrytëzuesit e PVF-ve.

Rekomandimi A2

Kryetarja duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin, kontrollimin dhe paraqitjen e saktë të vlerës së detyrimeve të papaguara, sipas kërkesës së rregullores për raportim financiar, në mënyrë që të mundësohet raportim i saktë i tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Realizimi i sasive të kontratave me çmime për njësi, në mos përputhje me peshët e përcaktuara në dosje të tenderit

Gjetja

Bazuar në Rregulloren nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 17.35 Kurdo që Autoriteti Kontraktues (AK) nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK.

Në kontratën “Rehabilitimi, mirëmbajtja e infrastrukturës dhe intervenimet e ndryshme në komunën e Graçanicës” me çmime për njësi, e ndarë në dy lote, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit:

- Në lot 2 “Rehabilitimi i shtretërve të lumenjëve dhe mureve mbrojtëse” me vlerë të parashikuar 1,100,000€, kategoria e parë (1) e paramasës së kontratës “Punimet përgatitore, dheut, zhavorit dhe gjeotekstilit”, është peshuar me 20% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 220,000€, ndërsa realizimi i kësaj kategorie deri në situacionin e shtatë ishte 30% e kontratës apo në vlerë 332,005€, duke tejkaluar vlerën e shpenzimit të lejuar të kategorisë për 112,005€ deri në këtë fazë të realizimit;
- Në lot 1 “Rehabilitimi i rrugëve lokale dhe urave” me vlerë të parashikuar 1,800,000€, kategoria e parë (1) e paramasës së kontratës “Punimet përgatitore, dheut, zhavorit dhe gjeotekstilit”, është peshuar me 20% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 360,000€, ndërsa realizimi i kësaj kategorie deri në situacionin e 13-të ishte 22% të vlerës së kontratës, apo në vlerë 398,048€, duke tejkaluar vlerën e shpenzimit të lejuar të kategorisë për 38,048€.

Këto tejkallime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave dhe përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit.

Ndikimi

Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo poashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore.

Rekomandimi A3

Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Sistemimi i stafit të sektorit të arsimit jo në përputhje me kontratat e punës****Gjetja**

Sipas Nenit 17 pika 1 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 theksohet se i punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur kontratë pune. Ndërkaq, pika 2 parasheh se në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me kontratën e punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës. Neni 84 pika 1 i këtij Ligji thekson se i punësuari është i detyruar që në vendin e punës t'iu përmbahet detyrimeve të parapara me ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës. Po ashtu sipas Strukturës Organizative dhe Rregullores për organizimit të brendshëm të Administratës Komunale është i përcaktuar organizimi i brendshëm dhe mënyra e marrjes së akteve të brendshme për sistematizimin e punëve.

Nga mostrat e testuara tek personeli, kemi vërejtur se në 20 raste mësimdhënësit nuk janë të sistemuar në vendin e punës në përputhje me kontratën. Sistemimi në këto pozita ishte bërë përmes vendimeve për sistematizim të përkohshëm me arsyetimin e rritjes së volumit të punëve. Sistemimi nuk kishte ndonjë afat të caktuar dhe ishte bërë për pozitat si: zyrtarë/asistent/shef për zhvillim ekonomik, urbanizëm, inspektor, administratë, kulturë, etj.

Vetëm në vitin 2023 ishin rekrutuar 14 mësimdhënës dhe dy administratorë të cilët ishin vendosur në departamentet tjera të komunës, duke mos e kryer funksionin dhe detyrat sipas konkursit dhe kontratës së punës.

Sipas zyrtarëve përkatës, kjo kishte ndodhur për shkak të numrit të pamjaftueshëm të pozitave të aprovuara të zyrtarëve në departamentet e caktuara të cilët i kanë pamundësuar rekrutimin e punëtorëve të rinj në proporcion me nevojat e komunës.

Ndikimi

Sistemimi i stafit jo në përputhje me pozitën sipas kontratave të punës paraqet shkelje të kërkesave ligjore dhe ndikon në nivel të ulët të përgjegjësisë dhe cilësisë në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Rekomandimi A4

Kryetarja duhet të sigurojë se të gjithë stafi arsimor të jetë i angazhuar në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë sipas kontratës së punës. Gjithashtu duhet të krijohet një harmonizim në mes të pozitave aktuale dhe atyre të buxhetuara në përputhje me ligjin për ndarje buxhetore i cili i përgjigjet nevojave të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Graçanicës në 2023 ishin në vlerë 2,654,690€, të cilat kanë pasur një rritje krahasuar me vitin e kaluar prej 36.5%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, lejet mjedisore, të hyrat nga qiraja, etj.

Çështja A5 - Aplikimi i zbritjes për tarifat e shfrytëzimit të pronës komunale afariste në mungesë të dëshmive të kërkuara sipas rregullores përkatëse

Gjetja

Në bazë të Rregullores nr.01/2021/KG për taksat, tarifat dhe gjobat komunale, neni 6.3.4, përcaktohen lehtësimet nga pagesa e taksave dhe tarifave, për shfrytëzimin e objekteve komunale afariste, ku përmes vendimit të Kuvendit Komunal, mund të përjashtohet qiramarrësi i cili pas fillimit të biznesit dëshmon me vërtetim nga ATK ose në një mënyrë tjetër ligjore se ai ka punësuar qytetarë të komunës të cilët nuk janë të afërmit e tij në vijën e drejtpërdrejtë farefisnore, nga 3-5 punonjës për të përfituar zbritjen prej 20%.

Ne kemi vërejtur se në tri (3) raste të faturimit për qiratë për shfrytëzimin e objekteve komunale afariste, ishte aplikuar zbritja prej 20%, në mungesë të dokumentacionit në dosje për plotesimin e kriterit të zbritjes. Për këto raste, në marrëveshjet e lidhura për qira nuk ishte cekur që do të aplikohet zbritja. Si pasojë e kësaj, komuna për vitin 2023, ka inkasuar të hyra më pak për 1,234€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me aplikimin e zbritjes për qiranë.

Ndikimi

Faturimi jo në përputhje me marrëveshjen dhe kërkesat e rregullores, ndikon në përfitimin e zbritjes në mungesë të dëshmive të kërkuara në rregullore dhe shkakton inkasim më të ulët të të hyrave komunale.

Rekomandimi A5

Kryetarja duhet të sigurojë mbikëqyrjen dhe verifikimin e marrëveshjeve për shfrytëzimin e objekteve komunale afariste, për të siguruar se zbritja për qiramarrësit aplikohet në përputhje me dëshmitë e kërkuara sipas rregullores përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,837,845€, derisa janë shpenzuar 3,085,803€ apo rreth 80.4% e buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të ndërtimit të rrugëve, blerjen e pajisjeve mbi 1,000€, ndërtesave të banimit, etj.

Çështja A6 - Përzgjedhja e tenderit me çmime jo normalisht të ulëta, pa dhënë shpjegime mbi bazën e këtyre çmimeve

Gjetja

Sipas Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik, neni 41.6, ceket se në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues (AK) duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik (OE) i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo normalisht të ulët".

Më tutje, neni 41.10 përcakton që "Pasi që AK merr shpjegimin me shkrim nga OE, AK duhet ose: a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët", brenda dy dite nga data e vendimit. Ndërsa neni 29.4 i rregullores, përcakton që AK, pasi që të jetë përputhur me nenin 61 të LPP-se, ka mjaft arsye për të besuar se Operatori ekonomik e ka dorëzuar një tender të pa-zbatueshëm (jo-normalisht të ulët), gëzon të drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata.

Tek procedura e prokurimit për kontratën "Rehabilitimi i rrugëve lokale dhe urave" lot 1 në vlerë 1,800,000€, me çmim të peshuar për njësi, operatori ekonomik fitues kishte ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, tek pozicioni III i paramasës së kontratës që përfshinë "Punët e betonit, armaturës" duke ofruar çmimin prej 2€ apo 3€ për metër kub për furnizim dhe punim me beton, përderisa në treg kjo vlerë varion prej minimum 65€ për metër kub e deri në 85€ për metër kub.

Tek procedura e njëjtë e prokurimit por për kontratën "Rehabilitimi i shtretërve të lumenjëve dhe mureve mbrojtëse" lot 2 në vlerë 1,100,000€, i njëjti OE fitues, kishte ofertuar çmime jo normalisht të ulëta, ku për disa nënpozicione tek "Punët e betonit, armaturës" kishte ofruar 10€ deri në 30€ për për metër kub për furnizim dhe punim me beton.

Komuna kishte kërkuar sqarime për të dy lotet për ofrimin e çmimeve jo normalisht të ulëta, duke kërkuar shpjegim të detajuar për çdo çmim nën treg. Megjithatë, operatori ekonomik në përgjigjen e tij, nuk kishte dhënë asnjë shpjegim për çmimet e ofruara, por vetëm ishte përgjigjur se zotohet se do t'iu përmbahet çmimeve të ofertuara dhe se do të kryejnë të gjitha pozicionet e cekura në paramasë.

Më tutje, komuna nuk kishte kërkuar nga OE të rrisë përqindjen e sigurimit të ekzekutimit, përkundër tenderit të ofruar me çmime jo normalisht të ulëta.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të mjaftueshme në vlerësimin e ofertave nga komisioni i vlerësimit dhe departamenti i prokurimit.

Ndikimi

Pranimi i ofertave me çmime jo normalisht të ulëta, tek tenderet me çmime të peshuara për njësi, rrezikon që punët e ofruara me këto çmime të mos realizohen, duke u realizuar përtej sasisë së kontraktuar ato pozicione ku janë ofruar çmime më të shtrenjta, apo punët të realizohen në cilësinë jo të duhur. Kjo poashtu ndikon negativisht në konkurrencën e drejtë në treg, duke shtypur OE tjerë që ofrojnë çmime të bazuara në kosto reale. Mos ofrimi i detajuar i shpjegimeve për këto çmime, paraqet jo transparencë të operatorit ekonomik.

Rekomandimi A6

Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në vlerësimin e ofertave me çmime jo normalisht të ulëta, duke kërkuar dhe siguruar shpjegime të detajuara mbi bazën e çmimeve të ulëta, sikurse analizën e kostove, burimet e materialeve, si dhe duke kërkuar rritjen e sigurisë së ekzekutimit të kontratës. Poashtu të sigurojë kryerjen e inspektimeve të rregullta lidhur me realizimin e cilësisë dhe sasisë së kontratës në fjalë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Graçanicës në pasqyrat financiare të vitit 2023 kishte prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,987,917€. Kjo vlerë ka të bëjë me operatorët që kanë mbetur borxh ndaj Komunës, taksat e aktivitetit, shpronësimin e tokës, etj.

Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 26, përcakton që Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore që kalojnë shumë 10€, ndërsa në nenin 27 përcaktohet se, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, Komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda 10 ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2023 ishin gjithsej 4,987,917€, prej të cilave 3,827,203€ apo 77% ishin për tatimin në pronë. Komuna vetëm kishte paralajmëruar tatimpaguesit për vonesat e tyre, por nuk kishte pasur asnjë rezultat në arkëtimin e këtyre borxheve. Më tutje komuna nuk kishte marrë veprime tjera lidhur me arkëtimin e borxheve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme të departamenteve përgjegjëse në tentim të mbledhjes së të arkëtueshmeve.

Ndikimi

Mos inkasimi i të arkëtueshmeve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B4

Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Komunë të Graçanicës operon me dy auditor të brendshëm. Për vitin 2023, kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik ku kishte planifikuar tetë auditime të rregullta. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 24 rekomandime. Prej tyre vetëm një ishte zbatuar, 13 ishin në proces të zbatimit dhe 10 rekomandime nuk ishin zbatuar fare. Periudha e mbuluar në raportet e NjAB kryesisht përfshinte vitin e kaluar deri në kohën e përfundimit të auditimit përkatës.

Çështja A7 - Mungesa e planeve të veprimit dhe niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga drejtoritë përkatëse

Gjetja

Sipas Nenit 10 pika 1.3 e Rregullores QRK nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, parashihet që Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik siguron zbatimin e rekomandimeve të pajtuara për auditimin e brendshëm sipas planit të veprimit.

Nga shtatë (7) raporte të auditimit të brendshëm, vetëm katër (4) drejtori kanë përgatitur plane të veprimit për implementimin e rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2023. NjAB në raportet e auditimit të brendshëm kishte dhënë gjithsej 24 rekomandime, dhe nga to vetëm një (1) rekomandim ishte zbatuar, 13 ishin në proces të zbatimit, ndërsa 10 nuk ishin zbatuar fare.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve në zbatimin e rekomandimeve nga drejtoritë përkatëse.

Ndikimi

Mungesa e planeve të veprimit dhe zbatimi i ulët i rekomandimeve ndikojnë negativisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe arritjen e objektivave të organizatës.

Rekomandimi A7

Kryetarja duhet të sigurojë se drejtoritë e audituara përgatisin planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB, dhe ndërmarrin veprime konkrete për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mosformimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Sipas Udhëzimit administrativ MF nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 4 pika 1 parasheh që çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjisllacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit. Ndërsa, neni 6 thekson se Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë.

Komuna gjatë vitit 2023, nuk e kishte të formuar Komitetin e Auditimit. Mandati i Komitetit paraprak kishte skaduar në tetor të vitit 2022, ndërsa nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme për emërimin e anëtarëve të rinj.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos ndërmarrjes së veprimeve nga ana e

Kryetares për emërimin e anëtarëve të rinj të Komitetit të Auditimit.

Ndikimi

Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit rezulton me mungesë të monitorimit të punës së NjAB-së, për të ofruar mbështetje menaxhmentit në vendimmarrje dhe të sigurojë që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar.

Rekomandimi A8

Kryetarja duhet të sigurojë marrjen e veprimeve për themelimin e Komitetit të Auditimit sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	8,767,352	10,171,925	9,318,337	7,841,438	7,978,563
Grante Qeveritare - Buxheti	6,585,729	6,847,864	6,698,911	5,105,187	5,161,256
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	185,787	41,897
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	0	0	234,740	812,017
Të bartura nga viti i kaluar	0	831,331	655,381	845,048	791,684
Të hyrat vetanake	2,181,623	2,485,445	1,964,046	1,470,676	1,169,815
Donacionet e jashtme	0	7,285	0	0	1,894

Buxheti final i Komunës së Graçanicës është më i lartë se buxheti fillestar për 1,404,573€. Kjo rritje e buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 262,135€, përfshirjes së të hyrave të bartura prej 303,822, të hyrave vetanake të bartura prej 831,331€ dhe donacioneve në vlerë prej 7,285€ në buxhet final.

Në vitin 2023, Komuna ka shpenzuar rreth 91.6% të buxhetit final ose 9,318,337€, me një rritje prej 3.6% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	8,767,352	10,171,925	9,318,337	7,841,438	7,978,563
Pagat dhe mëditjet	3,451,528	3,713,663	3,713,663	3,155,251	3,149,905
Mallrat dhe shërbimet	1,768,326	1,869,236	1,866,939	1,962,539	1,770,293
Komunalitë	202,000	285,495	226,781	200,530	179,976
Subvencionet dhe transferet	380,859	465,687	425,150	246,031	219,735
Investimet Kapitale	2,964,639	3,837,845	3,085,803	2,277,088	2,658,655

Komuna kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 262,135€. Buxheti final përbëhet vetëm nga granti qeveritar në vlerë prej 3,713,662€. Për periudhën janar - dhjetor 2023 realizimi i buxhetit ishte 99.9%
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 100,910€. Pjesa më e madhe e këtij buxhetit përbëhet nga granti qeveritar prej 1,627,050€, të hyrave vetanake prej 241,686€ dhe të hyrave të bartura prej 500€. Deri në fund të vitit 2023 realizimi i buxhetit ishte 99.8%;
- Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 83,495€. Ky buxhet përbëhet nga granti qeveritar 194,000€, të hyrave vetanake në vlerë prej 58,000€ dhe të hyrat vetanake të bartura prej 33,494€; Deri në fund të vitit realizimi i buxhetit ishte 79.4%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 325,686€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 315,859€, të hyrave vetanake prej 135,000€ dhe të hyrave vetanake për bartje prej 14,827€. Realizimi i buxhetit në fund të vitit ishte 91.3%;
- Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 873,205€. Ky buxhet përbëhet nga fondi qeveritar prej 997,292€, të hyrave vetanake prej 2,050,759€, të hyrave vetanake për bartje prej 782,508€ dhe donacioneve prej 7,285€. Deri në fund të vitit Komuna kishte arritur të shpenzoj 80.4% të buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Graçanicës në 2023 ishin në vlerë 2,654,690€, të cilat kanë pasur një rritje krahasuar me vitin e kaluar prej 36.5%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, lejet mjedisore, të hyrat nga qiraja, etj.

Gjithashtu në vitin 2023, Komuna e Graçanicës ka përfituar të hyra nga dënimet e trafikut në vlerë prej 217,681€ dhe gjobat e gjykatave në vlerë prej 15,610€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto mjete i planifikon dhe realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	2,181,623	2,181,623	2,654,690	1,944,896	1,866,079
Të hyrat tatimore	1,194,263	1,194,263	1,140,949	978,808	893,846
Të hyrat jo tatimore	987,360	987,360	1,513,740	966,087	972,233

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Komunës së Graçanicës ka rezultuar në shtatë (7) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023 rekomandime janë zbatuar tri (3) rekomandime, ndërsa katër (4) ishin nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të forcoj nivelet e kontrolleve me qëllim që të sigurohet se pagesat kryhen brenda afatit të rregullt ligjor prej 30 ditësh.	Nga mostrat e ekzaminuara nuk kemi hasur në vonesa të faturave përtej afatit ligjor.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të siguroj kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Nuk kemi hasur në raste të tilla në këtë vit.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetarja duhet të sigurojë se lëshimi i lejeve ndërtimore nga Drejtoria e Urbanizmit do të bëhet brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Nga mostrat e testuara, nuk janë hasur vonesa në shqyrtimin e lejeve ndërtimore në këtë vit.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Kryetarja të sigurojë zbatimin e duhur të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e duhur të pasurisë jo financiare kapitale nga zyrtarët e pasurisë në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.	Nuk janë marrë veprime pasi raporti i pasurive dhe stoqeve nuk ishte paraqitur në mënyrë të saktë.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, në mënyrë që të përmirësohet procesi i menaxhimit dhe prezantimit të drejtë të llogarive të arkëtueshme në RVF.	Raporti i llogarive të arkëtueshme edhe këtë vit nuk ishte shpalosur drejtë.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetarja duhet të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë marrë veprime të mjaftueshme lidhur me arkëtimin e të hyrave.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Detyrimet Kontingjente	Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së PVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.	Nuk janë marrë veprime pasi raporti i detyrimeve kontingjente ishte i mbivlerësuar.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Erëmira Bytyqi - Pllana, Udhëheqëse e ekipit



Nora Rashiti Nishefci, Anëtare e ekipit



Kushtrim Leci, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



**ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRACANICA**

POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2023 godinu kao i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog pisma, potvrđujem da:

- sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Gračanica, za godinu završno sa 31 decembrom 2023 (u daljem tekstu "Izveštaj");
- slažem se sa nalazima i preporukama i nemam neki komentar u vezi sa sadržajem izveštaja i da ću
- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.


Prof. dr Ljiljana Štarić
Predsednica Opštine Gračanica

Datum: 18.06.2024, Gračanica



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.